



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:059585
Datë: 30.04.2024
Numri i dokumentit: 05644529

KPPP.nr.693/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit Albatros International Logistics, me seli në Tiranë, Republika e Shqipërisë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avdi Ahmeti, avokat nga Prishtina, me adresë në rr. “Hajdar Dushi” nr. 46, në Prishtinë, kundër debitorit “3P” SH.P.K., me NRB: 810842303, me seli në rr. “Ahmet Krasniqi” në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.187/23 të datës 13.04.2023 të Përmbartuesit Privat Rezarta Metaj me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 30.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “3P” SH.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.187/23 të datës 13.04.2023, të Përmbartuesit Privat Rezarta Metaj.
- MBETET në fuqi Urdhri Përmbartimor P.nr.187/23 i datës 13.04.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Rezarta Metaj.
- DETYROHET debitori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim t’ia paguaj kreditorit shumën prej 104.00 € (njëqind e katër euro) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Albatros International Logistics, me seli në Prishtinë, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.187/23 të datës 13.04.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës Nr. 1/2022 të datës 02.09.2023; me të cilin e ka urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh pas pranimit të urdhrimit t'i paguajë kreditorit borxhin e mbetur në shumën prej 13,333.34 €, me kamatë vjetore në lartësi prej 8%, duke llogaritur nga data 02.09.2022 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, nën kërcënim të përmbartimit të detyrueshëm, me ndalimin e mjeteve në pra të cilat debitori i ka në llogaritë bankare, si dhe përmes regjistrimit, sekuestrimit, vlerësimit dhe shitjes së sendit të luajtshëm të debitorit deri në realizimin e borxhit në tërësi.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor duke deklaruar se faturat e lëshuara nga ana e kreditorit janë pa efekt juridik, për faktin se “Mjeti Gjysmë Rimorkio” me rastin e dorëzimit tek debitori nga kreditori nuk e ka pasur gjendjen për të cilën palët ishin marr vesh dhe se për defektet në rimorkio në mënyrë të vazhdueshme ishte njoftuar edhe vet kreditori, mirëpo i njëjti nuk ka ndërmarrë asnjë veprim konform marrëveshjes ndërmjet palëve. Më tutje ka theksuar se fatura dhe marrëveshja mbi bazën e të cilave është lejuar urdhri përmbartimor, nuk është nënshkruar nga ana e përfaqësuesve juridik të debitorit. Në rastin konkret fatura është nënshkruar nga një person i cili fare nuk paraqitet si pronar apo person i autorizuar i debitorit siç evidentohet edhe në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës, por i njëjti ka nënshkruar marrëveshjen dhe ka pranuar faturën në bazë të autorizimit të skaduar me datë 28.02.2022. Gjykatës i ka propozuar që të aprovet prapësimi i debitorit, të anulohet urdhri përmbartimor, të anulohen të gjitha veprimet e ndërmarra në këtë procedurë përmbartimore, si dhe të detyrohet kreditori që t'ia kompensoj shpenzimet procedurale debitorit.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, duke deklaruar ndër të tjerash se në shkresa të lëndës janë të gjitha dokumentet në origjinal duke përfshirë kontratën e shitblerjes së sendit të luajtshëm, faturën e kreditorit nga ana e kreditorit dhe e debitorit me vulë të dëshmisë së pranimit nga ana e debitorit. Më tutje ka shtuar se debitori

prej datës 02.09.2022 ka filluar që pagesat e faturës së lartcekur t'i paguaj në llogarinë bankare të kreditorit. Ka theksuar se i ka dorëzuar debitorit sendin e luajtshtëm sipas kontratës së datës 30.08.2022, por asnjëherë nuk ka pasur ndonjë vërejtje në funksionimin e të njëjtit, ashtu që me datë 02.09.2022 ka paguar pjesërisht faturën nr.1/2022 duke mbetur në detyrim për pjesën e cekur si në propozim, gjithashtu ka bashkëngjitur si provë edhe emailin e datës 27.03.2023 të komunikimit në mes të palëve. I ka propozuar gjykatës që të paguaj edhe shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim në shumën prej 208.00 € sipas TOAK.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës si dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar, andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”* dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm, përkatësisht Faturën Nr. 1/2022 të datës 02.09.2023, e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këtë faturë, janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara

shërbimet të cilat kanë qenë objekt i kësaj fature, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Gjykata në rastin konkret gjeti se pavarësisht faktit që fatura nuk është vulosur dhe nuk është e nënshkruar nga ana e debitorit, megjithatë i plotëson kushtet ligjore dhe ka tipare të dokumentit të besueshëm, meqenëse fatura në bazë të së cilës është lejuar përmbarimi rezulton se i është dërguar debitorit në mënyrë elektronike dhe se debitori përmes komunikimit elektronik të datës 15.03.2023 dhe 21.03.2023, ka konfirmuar pranimin e faturës dhe detyrimin e mbetur sipas kësaj faturë.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbarimi.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbarimore, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 463 dhe 453 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP-së, duke i'a njohur shpenzimet e të autorizuarit të kreditorit për përpilimin e përgjigjes në prapësim dhe atë në shumën prej 104.00 €, siç është e përcaktuar me rregulloren në fuqi për tarifën e avokatëve, të datës 18.03.2017 të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.693/23, datë 30.04.2024

Gjyqtari
Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.